

Buxheti publik i shëndetësisë¹ së RM për vitin 2016 nuk është progresiv.

Analiza e Buxhetit të shëndetësisë së RM tregon se në vitin 2016, sikur edhe në dhjetë vitet e kaluara, për shëndetësi do të shpenzohen mesatarisht **16% nga buxheti total i shtetit**.


Gjatë shpërndarjes së mjeteve në sektorë publike nuk është ndjekur parimi i buxhetimit sipas prioriteteve, por shpërndarja është bazuar në formulë matematikore paraprakisht të zhvilluar për alokim. Dhe buxheti i tillë nuk parasheh mjete dhe aktivitete që realisht do t'ju përgjigjen nevojave të qytetarëve për shërbime shëndetësore dhe mbrojtje shëndetësore, por thënë thjeshtë shëndeti i qytetarëve do të varet nga politika e përgjithshme buxhetore e Qeverisë së RM. (grafiku 1)

Buxheti i shëndetësisë së RM për vitin 2016 nuk është zhvillues.

Sipas strukturës së të dalave në buxhetin publik për shëndetësi për vitin 2016, pjesa më e madhe e mjeteve shpenzohet për furnizime të mallrave dhe shërbimeve, por në dhjetë vitet e fundit mjetet për këtë qëllim janë zvogëluar për 11 pikë poenë (në vitin 2006 për mallra dhe shërbime janë paraparë **89% nga buxheti për shëndetësi**, kurse në **vitin 2016 vetëm 78%**). Në periudhën e njëjtë institucionet shëndetësore zbatojnë shërbime për të cilat nuk pranojnë mjete, që krijon punë financiare të vazhdueshme negative të institucioneve shëndetësore publike dhe grumbullim i vazhdueshëm i borxheve, që rezulton me ulje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Në të njëjtën kohë, derisa zvogëlohen shpenzimet për mallra dhe shërbime rriten shpenzimet për subvencione dhe transferime (transferime ndaj ndërmarrjeve publike, ndërmarrjeve private dhe organizatave qytetare) ose **590% më shumë** dhe të dalat kapitale (objekte ndërtuese, pajisje, automjete dhe etj.) ose **352%**. (grafiku 2 dhe 3)


Grafiku 1:

Pjesëmarrja e buxhetit publik në buxhetin e përgjithshëm të RM në periudhën 2006 – 2014 – 2016 (në përqindje)




Grafiku 2:

Struktura e të dalave në buxhetin publik për shëndetësi për vitin 2016 (në milionë euro)



Grafiku 3:

Struktura e të dalave në buxhetin publik për shëndetësi në periudhën 2006 – 2014 – 2016 (në milionë euro)



1 Buxheti për shëndetësi i RM paraqet shumë të të dalave të Ministrisë për shëndetësi dhe Fondit për sigurim shëndetësor të RM – FSShM (buxheti i FSShM përfshin edhe të dalat e institucioneve publike shëndetësore në RM).

2 <http://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/2014/ESE%20Grant%20ORIO.pdf>

3 Fondi global për luftën kundër HIV/SIDA, malaria dhe tuberkulozë

Buxheti publik për shëndetësi i RM për vitin 2016 nuk i plotëson parimet e mos-diskriminimit dhe qasjes së barabartë në sigurimin e shërbimeve shëndetësore për grupet e ndryshme të qytetarëve. Në buxhetin për shëndetësi për vitin 2016 janë planifikuar mjete për shëndetin e romëve nëpërmjet përkrahjes dhe implementimin e dekadës dhe strategjisë së Romëve që janë për **29% më të ulëta nga mjetet në vitin.**


Në vitin 2006 në buxhetin për shëndetësi nuk janë paraparë mjete për avancimin e shëndetit të romëve nëpërmjet përkrahjes dhe zbatimit të Dekadës dhe Strategjisë së Romëve.

(grafiku 4)



Grafiku 4:

Lëvizja e mjeteve për avancimin e shëndetit të romëve nëpërmjet përkrahjes dhe zbatimit të Dekadës dhe Strategjisë së Romëve në periudhën 2006 – 2014 – 2016 (në milionë euro)




Buxheti publik për shëndetësi për vitin 2016 nuk zhvillohet në drejtim të politikës së përgjithshme ekonomike dhe qëllimeve për zhvillim ekonomik të RM.

Në vitin 2016 Qeveria e RM do të ndan **15% më shumë mjete për sigurimin shëndetësor të personave të papunësuar** krahasuar me vitin 2014. (grafiku 5) që tregon se **është planifikuar rritje e numrit të personave të papunësuar.**



Grafiku 5:

Lëvizja e mjeteve për sigurimin shëndetësor të personave të papunësuar në periudhën 2006 – 2014 – 2016 (në milionë euro)



Buxheti publik për shëndetësi për vitin 2016 bëhet akoma më i varur nga mjetet e siguruar nëpërmjet huave dhe donacioneve.

Në vitin 2016 shuma e mjeteve që Qeveria e Maqedonisë do t'i siguron për mbrojtje shëndetësore dhe shërbime shëndetësore në buxhetin qendror të RM nëpërmjet kredive **është për 210% më e lartë** krahasuar me vitin 2006. Kurse mjetet e siguruar nëpërmjet donacioneve në vitin 2016 do të jenë **për 40% më të larta** në krahasim me vitin 2006. (grafiku 6). Mjetet nga kreditë² janë kryesisht të parapara për ndërtim dhe rindërtim të objekteve ndërtuese, kurse mjetet nga donacionet 3 për pjesë të programeve parandaluese. Nga kjo mund të përfundojmë se modernizimi i infrastrukturës në shëndetësi varet prej huave, kurse pjesë e masave për mbrojtje shëndetësore parandaluese me donacione. Në të ardhmen modernizimi do të krijon barë shtesë për buxhetin qendror për shëndetësi, për pagesa të kamatave dhe shumës kryesore, kurse donacionet vënë në pikëpyetje qëndrueshmërinë dhe zbatimin e ardhshëm të pjesë të programeve parandaluese.



Grafiku 6:

Lëvizjet e mjeteve për shëndetësi të siguruar nëpërmjet huave dhe donacioneve në buxhetin qendror të RM në periudhën 2006 – 2014 – 2016 (në milionë euro)



■ Hua ■ Donacione

